




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kaçaniku
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulture
04.Nr.61-19390/2015
Me dt 17.06.2015

DREJTORIA E ARSIMIT DHE KULTURËS SHPALL KËTË:

KONKURS

PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) TË GJIMNAZEVE DHE TË SHKOLLAVE
PROFESIONALE PËR VITIN SHKOLLOR 2015/2016

Konkursi shpallet duke u bazuar në Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032 si dhe në Udhëzimin Administrativ Nr.22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës nxënës.

Konkursi shpallet me këto kushte dhe kriteret:

1.Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, të gjimnazeve dhe të shkollave profesionale, për vitin shkollor 2015/16, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë mbaruar klasën e 9- të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin e dëftesave në MASHT dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe shkolla profesionale, duhet të paraqesin këto dokumente:

Fletëparaqitjen (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)

Dëftesën origjinale për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe

Certifikatën e lindjes.

1. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe shkolla profesionale për vitin shkollor 2015/2016, bëhet më datën 18, 19 dhe 22 qershor 2014 në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora 8.00-16.00.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse me datën 23.06.2015.

Kthimi i dokumenteve për nxënësit, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet prej 24.06.2015.

Kandidati i refuzuar dhe i cili dyshon se i janë shkelur kriteret e regjistrimit ka të drejtë, brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve t'i paraqes ankesë drejtorisë së shkollës, Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe në raste të jashtëzakonshme edhe MASHT - komisionit për ankesa.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

1. Suksesi nga shkollimi i obliguar (25%) 25 pikë
2. Suksesi nga lëndët prioritare në test (15%) 15 pikë
3. Numri i pikëve nga testi (60%) 60 pikë

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë 100 pikë.

Gjimnazi "Skenderbeu"
Kaçanik

Nr.	Drejtimi	Nr. i nxënësve	Nr.i paraleleve
1	Gjim.Shkencave Natyrore	140	5
2	Gjim.Shkencave Shogore	112	4
		256	9

Shkolla e Mesme Profesionale
 "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka"
 Kaçanik

Nr.	Drejtimi	Profili	Nr. nxënësve	Nr.paraleleve
1	Elektroteknikë	1.Teknik i telekomunikacionit 2.Teknik i informatikës 3.Instalues elektrik 4.Mekatronië	32 32 24 32	1 1 1 1
2	Ekonomi	1.Asistent i marketingut 2.Banka dhe sigurime	32 32	1 1
3	Makineri	1.Transport rrugor 2.Instalues i ngrohjes qendrore 3.Instalues ujesjellsit dhe kanalizimit 4.Salldator 5.Automekanik	32 24 24 24 24	1 1 1 1 1
4		Ndertimtari	32	1
5	Juridik	1.Asistent Juridik	32	1
			376	13

Kaçanik më:

17.06.2015



Drejtori i DAK-së

Enver Kamishi